



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.72/2019  
Prishtinë, më 23.7.2019, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Muharrem Nitaj, Veton Berisha, anëtarë.

**Munguan:** Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Glauk Konjufca, Liburn Aliu dhe Duda Balje, anëtarë.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Fatlind Azizi – KDI; Liridon Gashi – SEFF; Vatra Qehaja – LVV; Marigona Bajrami – PSD dhe mediat.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Besim Haliti, si dhe praktikanti Afrim Berisha.

**Mbledhjen e kryesoi, Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.**

Rendi i ditës:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 16.7.2019;
- 3.Shqyrtimi i raportit të punës së komisionit për sesionin pranveror 2019;
- 4.Të ndryshme.

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16.7.2019**

*Procesverbali i mbledhjes së datës 16.7.2019, u miratua pa vërejte.*

## **3. Shqyrtimi i raportit të punës së komisionit për sesionin pranveror 2019**

**Kryetarja** theksoi se komisioni, gjatë sesionit pranveror 2019 të Legjislaturës VI, realizoi gjithsej 52 (pesëdhjetë e dy) aktivitete, me një mesatare prej 7 (shtatë) aktivitete në muaj. Punën e komisionit e monitoruan përfaqësuesit e Zyrës së BE-së, NDI-së, INDEP-it, KDI-së, DPLUS, asociacione dhe organizata të tjera. Po ashtu, puna e komisionit pati hapësirë të mjaftueshme edhe në media të shkruara dhe në ato elektronike. Me këtë rast, shpreh falënderim për OJQ INDEP dhe DPLUS, që e përkrahen një numër të aktiviteteve të komisionit, me analiza të pavarura. Gjatë këtij sesioni, komisioni e shqyrtoi dhe miratoi Projektstatutin e Trepçës. Edhe pse ishte paraparë procedimi i projektligjeve nga Qeveria, në bazë të strategjisë legjislative për vitin 2019, nuk është proceduar asnjë projektligj. Komisioni ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të KOSTT-it. Po ashtu, në bazë të fushëveprimit të tij, gjatë këtij sesioni shqyrtoi të gjitha raportet vjetore të agjencive të pavarura, të themeluara nga Kuvendi. Gjatë sesionit pranveror, komisioni ka përfunduar mbikëqyrjen e zbatimit të dy ligjeve si vijon: Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për energjinë elektrike dhe mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për shërbime. Duke ushtruar mandatin e tij si mbikëqyrës i punës së Qeverisë/ministrive që i raportojnë komisionit, ministrat e dikastereve përkatëse apo zëvendësit e tyre janë ftuar për raportim dhe në seanca dëgjimore në komision. Në këtë periudhë kemi pasur 6 raportime të ministrave. Komisioni realizoi edhe anën e bashkëpunimit ndërkombëtar, kështu që gjatë këtij sesioni realizoi gjithsej 2 vizita jashtë vendit (Bruksel dhe Zagreb). Ndërsa, i realizoi 11 vizita brenda vendit, me qëllim që të shohë për së afërmi gjendjen në institucionet dhe subjektet, veprimtaria e të cilave ka të bëjë me fushëveprimin e komisionit. Sa i përket vizitave brenda vendit, kryetarja kritikoi deputetët, të cilët kanë munguar zakonisht në vizita brenda vendit.

*Komisioni, unanimisht, nxori këtë:*

*Përfundim*

*Miratohet raporti i punës së komisionit për sesionin pranveror 2019.*

## **4. Të ndryshme**

### **Çështjet vijuese**

**Mbledhja përfundoi në orën 11:30.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,**

**Sala BERISHA SHALA**